



Në bazë të nenit 47, paragrafit (1), pikës 6) të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16 dhe 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 110/21), nenit 206, paragrafit (3) të Ligjit të Shërbimeve të Pagesave dhe të Sistemeve të Pagesave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 90/22) dhe nenit 186, paragrafi (2) të Ligjit të Bankave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 67/07, 90/09, 67/10, 26/13, 15/15 153/15, 190/16 7/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 101/19 dhe 122/21), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, miratoi

RREGULLORE

për formën dhe elementet e detyrueshme të urdhërpagesës për kundërvajtje

Neni 1

Me këtë Rregullore për formën dhe elementet e detyrueshme të urdhërpagesës për kundërvajtje (në tekstin e mëposhtëm: Rregullorja) përshkruhen forma dhe elementet e detyrueshme të formularit të urdhërpagesës për kundërvajtje, të cilin personat e autorizuar të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, e kryejnë monitorim jashtë terrenit dhe në terren (në tekstin e mëposhtëm: persona të autorizuar) janë të obliguar t'i lëshojnë personit fizik ose juridik dhe personit përgjegjës në personin juridik (në tekstin e mëposhtëm: autori i veprës), gjatë zbatimit të procedurës së lëshimit të urdhërit të kundërvajtjes.

Neni 2

Për veprat që janë të parashikuara me Ligjin e Shërbimeve Pagesore dhe të Sistemeve Pagesore dhe Ligjit të Bankave, personat e autorizuar janë të obliguar autorit të kundërvajtjes t'i propozojnë procedurë për shlyerje me lëshimin e urdhërpagesës për kundërvajtje, në pajtim me Ligjin e Kundërvajtjeve.

Neni 3

Formulari i urdhërpagesës për kundërvajtje është shtypur në letër të bardhë me A4 format me memorandum të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Formulari i urdhërpagesës për kundërvajtje duhet detyrimisht të përmbajë të dhëna për autorin e veprës (emër, mbiemër, adresë dhe numrin e amzës të qytetarit, nëse bëhet fjalë për person fizik të huaj edhe numri i pasaportës dhe shtetit, për person juridik - titullin, selinë dhe numrin e tatimit), të dhëna për kundërvajtjen e bërë (vendi dhe koha e veprës, kualifikimi ligjor i veprës dhe numri i procesverbalit të veprës), të dhëna për shumën e gjobës së shqiptuar, si dhe të dhëna për llogarinë pagesore në të cilën duhet të paguhet gjoba, udhëzim ligjor, nënshkrim i autorit të veprës dhe emri, mbiemri dhe nënshkrimi i personit të autorizuar.

Forma dhe elementet e detyrueshme të urdhërpagesës për kundërvajtje nga paragrafi (2) i këtij vendimi janë të dhëna në shtojcën 1, i cili është pjesë përbërëse e kësaj rregullore.

Neni 4

Me hyrje në fuqi të kësaj rregullores, ndalon së vlejtori Rregullorja për formën dhe përmbajtjen e urdhërpagesës për kundërvajtje ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 173/15).

Neni 5

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e tete nga dita e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Rr. nr. 02-15/XXII-1/2022
28 dhjetor 2022
Shkup

Guvernatorja
dhe kryesuesja e Këshillit të
Bankës Popullore të Republikës së
Maqedonisë së Veriut
д-р Анита Ангеловска-Бежоска

SHTOJCA 1

Nr. UK

Data:

Në bazë të _____, datë _____, lëshohet

URDHËRPAGESË PËR KUNDËRVAJTJE**1. Të dhëna për autorin e veprës**

Emri dhe mbiemri i personit fizik / titulli i personit juridik:

NAQ-i i personit fizik / NUT-i i personit juridik:

Numri i pasaportës së personit të huaj fizik, i lëshuar nga shteti:

Adresa e vendbanimit / të përkohshëm / të përhershëm / selia / shtetësia:

2. Të dhëna për veprën e kryer

Dita:

Ora:

Vendi:

Përshkrimi i veprës:

Kualifikimi ligjor i veprës:

Procesverbali për veprën e kryer:

Nr.

Data:

3. Të dhëna për gjobën*

Gjobë për personin juridik:

EUR

Gjobë për personin përgjegjës në personin juridik:

EUR

Gjobë për personin fizik:

EUR

* Për secilën nga gjobat e theksuara më lartë hartohet nga një urdhërpagesë dhe plotësohet përkatësisht.

4. Të dhëna për pagesë të gjobës:

Pagesa e gjobës për vepër të kryer bëhet me transferim të fondeve në dobi të llogarisë pagesore të thesarit 100000000063095 - Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në llogarinë pagesore 840***05535 dhe shifër hyrëse 722155 me kundërvlerë të denarit të shumës së gjobës në euro.

Udhëzim ligjor:

Autori i veprës i cili do ta paguan gjobën në afat prej tetë ditëve nga dita e pranimi të urdhërpagesës për kundërvajtje, do të paguaj vetëm gjysmën e gjobës së shqiptuar. Autori i veprës është i obliguar ta paguajë gjobën në afat prej tetë ditëve nga dita e pranimi të urdhërpagesës për kundërvajtje dhe menjëherë të dorëzojë dëshmi për arkëtimin te Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Nëse autori i veprës nuk e

paguan gjobën në afat prej tetë ditëve nga dita e pranimi të urdhërpagesës për kundërvajtje dhe nuk dorëzon dëshmi për arkëtimin, do të dorëzohet kërkesë për hapjen e procedurës për kundërvajtje te gjykata kompetente, ose tek organi i kundërvajtjes.

Kundër urdhërpagesës për kundërvajtje nuk lejohet ankesa.

Autori i veprës

(Personi përgjegjës në personin juridik /
personin fizik)

Emri, mbiemri dhe nënshkrimi

Personi i autorizuar

Emri, mbiemri dhe nënshkrimi

m.p.